



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2024:043358

Datë: 09.07.2024

Numri i dokumentit: 05912872

PKR.nr.120/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, në përbërje nga kryetari i trupit gjykues – gjyqtari Naser Foniqi – në vijim KTGJ, **me bashkëpunëtoren profesionale Arbenita Hoxha Koleci**, në çështjen penale të akuzuarve **V.K. e R.H.**, për shkak se kanë kryer veprën penale Grabitje në bashkëkryerje nga neni 317 par. 1 lidhur me nenin 31 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës – në vijim KPRK, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda **PP.I.nr.29/2024, të datës 21.06.2024**, pas shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur më datë **03.07.2024**, në të cilin kanë qenë të pranishëm: prokurori i shtetit Javorka Prlincevic, i akuzuari **V.K.**, me mbrojtësin e tij av. Skënder Musa me autorizim; i akuzuari **D.K.** me mbrojtësen e tij av. Merita Bogaj e caktuar sipas detyrës zyrtare që nga faza e procedurës paraprake **dhe** i akuzuari **R.H.** me mbrojtësen e tij av. Merita Bajraktari e caktuar sipas detyrës zyrtare që nga faza e procedurës paraprake, si dhe përkthyesja e gjykatës B.K., me datë **05.07.2024**, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

V.K., i biri i Safet dhe H., e vajzërisë C., i lindur me datë ... në Prishtinë, rruga "...", numër ..., me numër personal ..., student në Fakultetin Ekonomik, i pa martuar, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, **gjendet nën masën e paraburgimit prej datës 06.02.2024, dhe**

R.H., i biri i G. dhe Xh., e vajzërisë H., i lindur me datë ..., në Prishtinë, ..., rruga "...", numër ..., me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, baba i një fëmije, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, **gjendet nën masën e paraburgimit prej datës 06.02.2024**

JANË FAJTORË

S e p s e: me datë 04.02.2024 rreth orës 23:55, në pompën e derivateve "Sh...", e cila ndodhet në Prishtinë në rrugën "...", pas marrëveshjes paraprake, në bashkëkryerje kanë kryer grabitjen e punëtorëve të pompës si më lart, në mënyrë që, me të arritur në pompë me veturën e tipit "Audi Q5", ngjyrë hiri, me targa ..., të cilën sipas deklaratave të tyre të dhëna në polici dhe prokurori e ka drejtuar tani i akuzuari D.K., pastaj të akuzuarit K. e H. kanë hyrë në marketin e

pompës së derivateve dhe kanë sulmuar fizikisht punëtorët e kësaj pompe - tani të dëmtuarit E.K. dhe G.G., të cilëve gjatë gjithë kohës iu kanë kërkuar të holla me kanosje se do ta nxjerrin armën në qoftë se të dëmtuarit nuk ua japin paratë, pastaj të akuzuarit K. e H. kanë marrë nga arka e marketit të holla në vlerë prej 149,95 euro dhe 4 pako të cigareve të markës Marlboro në vlerë të përgjithshme prej 12,40 euro, më pas të dëmtuarve si më lart ua kanë kontrolluar xhepat duke kërkuar të holla dhe kanë dalë nga marketi, kanë hipur në veturën si më lart dhe menjëherë kanë ikur nga vendi i ngjarjes,-

- me këto veprime, në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Grabitja nga neni 317 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK.

Prandaj gjykata në bazë të neneve: 38; 42; 43; 69; 79, par 1; 317 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK dhe nenit 364 të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale – në vijim KPP, të akuzuarve **V.K. e R.H., secilit veç e veç**, iu shqipton:

DËNIM ME GJOBË DHE BURGIM

- **Dënim me gjobë në shumë prej një mijë (1000) €, dhe**
- **Dënim me burgim në kohëzgjatje prej tri (3) vite**, të cilat dënime do të ekzekutohen brenda afatit prej 15 ditësh por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të merr formën prerë.
- Nëse dënimi i shqiptuar në të holla ndaj të akuzuarve si më lart nuk mund të ekzekutohet, gjykata do t'ua caktoj të dënuarve një ditë burgimi për 20 € të gjobës
- Në dënimin e shqiptuar, të akuzuarve iu llogaritet edhe koha e kaluar nën masën e paraburgimit **prej datës 06.02.2024 e derisa të jenë nën këtë masë.**
- Të akuzuarve **V.K. e R.H.** iu vazhdohet masa e paraburgimit deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit të kësaj gjykate PKR.nr.120/2024, të datës 05.07.2024, por jo më shumë se dënimi i shqiptuar me këtë aktgjykim.
- Obligohen të akuzuarit, që secili veç e veç t'i paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare, **ndërsa në emër të paushallit gjyqësor duhet të paguaj shumën prej njëqind (100) €, si dhe nga pesëdhjetë (50) € në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit**, në afat prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.
- **Të dëmtuarit E.(S.)K.**, nga Prishtina, rruga “...” dhe **G.(N.)G.**, nga Prishtina, rruga “Dëshmorët e Marecit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko civil.

A R S Y E T I M I

Pas kallëzimit penal të Policisë së Kosovës/Drejtoria Rajonale e Policisë nr. 2024-AB-0287, të datës 07.02.2024, Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktakuzën **PP.I.nr.29/2024, të datës 21.06.2024**, ka akuzuar të pandehurit **V.K., D.K. dhe R.H.**, për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale Grabitje në bashkëkryerje nga neni 317 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK.

Në seancën e shqyrtimit fillestar të datës 03.07.2024, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, të akuzuarit **V.K. dhe R.H.** kanë deklaruar se e kanë kuptuar aktakuzën dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësit e tyre e kanë pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën janë akuzuar, ndërsa i akuzuari D.K. është deklaruar i pa fajshëm, e pastaj pas mendimit të palëve në procedurë, gjykata ka marrë aktvendimin PKR.nr.120/2024 të datës 05.07.2024 me të cilin ka veçuar procedurën penale për të akuzuarin K.

Sa i përket pranimit të fajësisë nga të akuzuarit, prokurori i shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve V.K. dhe R.H. sepse ky pranim është bërë konform me ligjin dhe me vet dëshirë, si dhe vërtetohet me provat materiale të propozuara në aktakuzë, prandaj i ka propozuar gjykatës që ta pranojë pranimin e fajësisë të pandehurve.

Mbrojtësi i të akuzuarit **V.K.**, av. Skënder Musa ka deklaruar se pranimi i fajësisë nga i mbrojturi i tij është bërë konform nenit 242 të KPP, pas konsultimit të mjaftueshëm më të si mbrojtës, duke shtuar se V. e ka të qartë se për veprën penale të cilën e ka kryer do të shpallet fajtor dhe do të dënohet, e gjithashtu e ka të qartë se pranimi i fajësisë në këtë fazë të procedurës do të merret si rrethanë lehtësuese, pasi këtë pranim fajësie e ka bërë edhe në prokurori dhe e ka sqaruar në tërësi ngjarjen e cila përputhet plotësisht me video incizimin i cili gjendet në shkresat e lëndës, duke i propozuar gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajësisë sepse i njëjti bazohet në thëniet si më lart. pastaj, mbrojtësi Musa ka thënë se sa i përket dënimit konsideron se ekzistojnë arsye ligjore për zbutje të dënimit dhe rrethana posaçërisht lehtësuese që i parasheh neni 71, par.1 nënpar.1.3 i KPRK, në rastet kur kryesi i veprës penale pranon fajësinë ose ka arritur marrëveshje për pranim fajësie, e përveç kësaj konsideron se si rrethanë lehtësuese gjykata duhet ta merr parasysh faktin e sqarimit të kësaj çështje ne prokurori duke e përshtuar në tërësi situatën se si ka ndodhur, duke treguar faktin se ka qenë nën ndikimin e substancave narkotike të llojit kokainë – krek, dhe se si mbrojtës e ka të qartë se dehja me çfarëdo substance nuk e bën të mbrojturin e tij të pa përgjegjshëm në aspektin penal, mirëpo prapë se prapë e zvogëlon aftësinë për t'i kontrolluar veprimet e tij dhe vullnetin e tij për kryerjen e veprës penale dhe se në periudhën sa ka qëndruar nën masën e paraburgimit vazhdimisht ka përdorur terapi dhe gjendja e tij shëndetësore është përmirësuar dhe përveç kësaj, babai i tij ka arritur të gjej një ordinancë specialistike në Prishtinë që merret me shërimin e personave të varur nga substancat narkotike. Prandaj, mbrojtësi Musa ka propozuar që me rastin e matjes së dënimit të mbrojturit të tij t'ia shqiptoj një dënim nën minimumin e paraparë pasi janë plotësuar kushtet ligjore e gjithashtu është e rrugës që t'i jepet një mundësi për shërim dhe rehabilitim në mënyrë që t'i kthehet jetës si qytetarë i ndershëm i vendit, duke shtuar se për fat të mirë pasoja e shkaktuar gjatë kësaj veprë penale është 149 euro dhe 4 pako cigare, nuk ka persona të lënduar, e për këtë konsideron se gjykata duhet ta ketë parasysh edhe peshën e dëmit të cilën familja e V. është e gatshme që ta kompensoj. Në fund të fjalës së tij, mbrojtësi Musa i ka propozuar gjykatës që ta heqë masën e paraburgimit pasi nuk ka arsye që i mbrojturi i tij të qëndroj nën këtë masë dhe me qëllim që t'i nënshtrohet trajtimit mjekësor.

I akuzuari V.K. ka deklaruar se është penduar për veprën penale të kryer, se i vjen shumë keq që ka ndodhur dhe i kërkon falje të dëmtuarve, iu premton se do t'ua kompensoj dëmin e shkaktuar dhe pajtohet me fjalën e mbrojtësit të tij.

Edhe mbrojtësja e të akuzuarit **R.H.**, av. Merita Bajraktari ka thënë se pas konsultimit të mjaftueshëm me të mbrojturin e saj R.H., i njëjti ka pranuar fajin dhe ajo si mbrojtëse pajtohet plotësisht lidhur me pranimin e fajësisë, duke konsideruar se ky pranim i fajit është bërë konform ligjit dhe përputhet me provat materiale në shkresat e lëndës, duke konsideruar se edhe nga ana e gjykatës ky pranim i fajit do të konsiderohet dhe pranohet si rrethanë lehtësuese gjatë marrjes

së vendimit lidhur me lartësinë e dënimit edhe pse ky pranim i fajësisë është bërë në këtë fazë të procedurës. Pastaj, mbrojtësja Bajraktari ka thënë se dëmi i shkaktuar është minimal, rrethanë e cila konsideron se do të merret për bazë dhe do të llogaritet me rastin e llogaritjes së lartësisë së dënimit si dhe faktin se i mbrojturi i saj është përnduar thellë për këtë që i ka ndodhur, duke premtuar se veprimet si këto apo të ngjashme nuk do t'i përsëris më në jetën e tij, por do t'i kthehet normalitetit dhe jetës me dinjitet. Në fund të fjalës së saj, mbrojtësja Bajraktari ka propozuar që të mbrojturit të saj t'i ndërpritet masa e paraburgimit, pasi kanë ndryshuar kushtet ligjore për këtë masë kaq të rëndë.

I akuzuari R.H. ka thënë se pajtohet me fjalën e mbrojtëses së tij, se është i përnduar për veprën penale të kryer, se i vjen shumë keq që ka ndodhur, iu ka kërkuar falje të dëmtuarve, duke premtuar se do t'ua kompensoj dëmin e shkaktuar, duke shtuar se është pranë martesës dhe ka një fëmijë nëntë muajsh, se ka dëshirë t'i kthehet jetës familjare, me arsyetim se ky rast i ka ndodhur nën ndikim të drogës, nuk ka qenë vetvetja dhe ka premtuar se nuk do të përsëris më kesi veprë penale.

Pas deklarimit fajtorë nga të akuzuarit K. e H., mendimit të prokurorit të shtetit dhe mbrojtësve të akuzuarve, KTGJ me aktvendim ka pranuar pranimin e fajësisë nga të akuzuarit, pasi është bindur se të njëjtit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, se ky pranim është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit, se pranimi fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimit apo premtimit, si dhe është mbështetur në faktet që përmban aktakuza e cila nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Meqenëse të akuzuarit K. e H. e kanë pranuar fajësinë, për arsye të efikasitetit të përfundimit të procedurës penale ndaj tyre, përkatësisht me qëllim të një gjykimi të drejtë dhe në kohë sa më të shkurtër të paraparë me dispozitat e KPP dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjykata ka vendosur ta veçojë procedurën penale ndaj të akuzuarve si më lart.

Po ashtu, edhe nga provat materiale në shkresat e lëndës përkatësisht: procesverbali për identifikimin e të dyshuarit 2024-AB-287 i datës 06.02.2024 sipas të cilit tani i dëmtuari – dëshmitari G.G., pas prezantimit të fotografive të nëntë personave të ndryshëm, ka deklaruar se të pranishëm në rastin e grabitjes në pompën e derivateve Sh... në Prishtinë, në rr. "...", me datë 04.02.2024 kanë qenë personat me numrat 3 dhe 9, duke shtuar se këtë e mban mend në bazë të konstruktit dhe syve, ndërsa për personin e tretë ka thënë se ai ka qëndruar në veturë, e ka vërejtur se i njëjti ka mjekër por nuk ka arritur ta shoh nga afër. Në fotografitë e personave të ndryshëm në numrin 3 ka rezultuar të jetë tani i akuzuari V.K. ndërsa në numrin 9 ka rezultuar të jetë tani i akuzuari R.H.. Nga video incizimet të cilat ndodhen në shkresat e lëndës, është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprimet ashtu siç janë përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Andaj, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarve ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale Grabitja në bashkëkryerje nga neni 317 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK, si dhe vërtetoi gjendjen faktike, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata edhe i shpalli fajtorë të akuzuarit, pasi që më parë gjeti se janë penalisht përgjegjës.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të akuzuarve gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese si në vijim: pranimin e fajësisë nga të akuzuarit që nga kryerja e veprës penale për të akuzuarin V.K. ndërsa që në shqyrtim fillestar nga i akuzuari R.H. dhe moshën e re të akuzuarit V.K., përkatësisht në kohën e kryerjes së veprës penale i njëjti ka qenë 21 vjeç dhe 5 muaj, si dhe sinqeritetin e treguar gjatë shqyrtimit fillestar, përkatësisht të njëjtit pa asnjë hezitim e kanë pranuar fajin për veprën penale të kryer. Ndërsa si rrethana rënduese

gjykata ka marrë rrethanat si në vijim: intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur përkatësisht tani të akuzuarit K. e H. kanë qenë të ashpër gjatë kryerjes së veprës penale, të njëjtit i kanë sulmuar me grushte tani të dëmtuarit dhe i kanë kanosur se do të nxjerrin armë në qoftë se të dëmtuarit K. dhe G. nuk ua japin paratë; sipas të dhënave të kësaj gjykate tani i akuzuari K. ka qenë i dënuar edhe më parë për veprat penale Lëndim i lehtë trupor, me aktgjykimin P.nr.805/2022, i formës së prerë nga data 10.10.2022 dhe Vjedhja, me aktgjykimin P.nr.2755/2021, i formës së prerë nga data 25.04.2024, me të cilat i është shqiptuar dënim me gjobë dhe dënime me kusht me burgim, ndërsa i akuzuari H. ka qenë i dënuar edhe më parë për veprat penale: Dhuna në Familje dhe Sulmi, me aktgjykimin P.nr.1455/2020, i formës së prerë nga data 27.11.2020 me të cilin i është shqiptuar dënim me kusht burgimi; Dhuna në Familje, me aktgjykimin P.nr.1902/2020, i formës së prerë nga data 29.12.2020 me të cilin i është shqiptuar dënim me kusht burgimi; Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, me aktgjykimin P.nr.162/2019, i formës së prerë nga data 22.07.2021, me të cilin i është shqiptuar dënim me gjobë. Po ashtu, tani i akuzuari R.H. ka qenë i dënuar edhe si i mitur me aktgjykime të formës së prerë, për veprat penale: Mbjatja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374, par. 1, të KPRK; Grabitja nga neni 329 i KPRK; dy vepra penale Lëndim i rëndë trupor nga neni 189 i KPRK dhe Vjedhje e rëndë nga neni 327 i KPRK.

Prandaj, bazuar në rrethanat si më lart, gjykata të akuzuarve iu shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën janë shpallur fajtorë, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarve dhe se me dënimin e shqiptuar atyre, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK, përkatësisht të parandaloi kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëj rehabilitimin e tyre, të parandaloi persona të tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga veprat penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, për ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Në këtë rast, gjykata është bazuar edhe në nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, për një proces të hapur dhe të rregullt, që çdo person i akuzuar ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, duke pasur parasysh edhe bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij, si dhe në parimin që çdo person i akuzuar për një vepër penale të prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

Pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtë, në bazë të nenit 462, par. 1 dhe 2 të KPP, palët e dëmtuara janë udhëzuar në kontest të rregullt juridiko - civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 453, par. 1 të KPP, ndërsa vendimi mbi taksën për kompensimin e viktimave të krimit u mor në bazë të nenit **36, par. 3.2 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.**

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të neneve 317 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK dhe 364 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë **09.07.2024.**

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.120/2024, datë 05.07.2024.

Bashkëpunëtoreshë profesionale,
Arbenita Hoxha Koleci

Kryetari i trupit gjyqës,
Naser Foniqi

UDHËZIMI PËR MJETET JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar **brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh** nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, me seli në Prishtinë.